


INTERVISTE E Z. OSMAN TOÇI, NIPIT TE PATRIOTIT TE MADH SHQIPTAR SHAHIN TOÇI, DHENE GAZETES TELEGRAF, ME DT. 15 PRILL 2011.



INTERVISTA/ OSMAN, NIPI I PATRIOTIT TË MADH SHQIPTAR SHAHIN TOÇIT, RRËFEN

Shahin Toçin, si e zhduku SIM-i

Leonard VEIZI

Ato janë lodhur shumë, por amanetin nuk e kanë harruar për asnjë çast. Për 18 vjet me radhë kanë jetuar me të njëjtën moto si të bëjnë të mundur të sjellin eshtrat e patriotit Shahin Toçi nga varrezat e Veranës së Romës, tek ato të dëshmorëve në Mat. Dhe ia kanë arritur. Vetëm pak ditë më parë, një ceremoni madhështore u zhvillua në qytetin e Burrelit dhe eshtrat e Shahin Toçit, pas 72 vjetësh mërgim, u prehen në Atidhe. Osman Toçi, një nga nipat e Shahin Toçit e ka ndjekur hap pas hapi historinë e xhaxhait të tij dhe padyshim është njohësi më i mirë i saj. Ai thotë se ka qenë amaneti i të parëve, prandërsve dhe të afërmeve të tjerë të tij se: "Ne nuk na tret dheu pa u kthyer eshtrat e Shahin Toçit në atidhe".

...Shahin Toçi, një oficer i ri shqiptar që studioje në Itali në një kurs pas akademik, u ekzekutua në mënyrë barbare nga Shërbimi Sekret i Musolininit, vetëm se ai nuk pranoi të betohej si fashist, dhe bëri rezistencën e tij ndaj pushtimit ushtarak të Shqipërisë. Osman Toçi, duke iu referuar historisë së xhaxhait të tij, të cilën e ka mblodhur me kujdes prej shumë vitesh, rrëfen gjithëka mundet për gazetën "Telegraf".

Pse ndodhje Shahin Toçi në Romë në vitet 1938-'39?

Shahin Toçi pasi ishte titulluar oficer dhe u emëruar në Ministrinë e Mbrojtjes në 1938 në departamentin e financës. Për arsye të kualifikimit për gradë më të lartë e tituj karriere mbretëria e dërgoi për specializim në Romë, në shkollën "Cavallieri & Finances". Në kohën që mori specializimin nga ana e qeverisë së kohës, xhaxhai im shkoi tek prindërit e të afërmit dhe u komunikoi. Gjyshi shtroi një dreqë për miqtë që kishte dhe një dreqë për fisin, gjakun, kushërinjtë dhe katundin në Uzallë të Matit. Një detaj interesante gjatë dreqës, ishte kur ai iu drejtua miqve: "Unë po ik në Itali por Italia do të vijë para meje këtu në Shqipëri". Kishin të parasysh pushtimin. Të afërmit i reko-

manduan të mos shkonte në Itali, por ai u tha se kudo që të shkonte do të luftonte veç për vendin e tij. E përcollën njerëzit më të afert të gjakut, vëllezërit, prindërit dhe dajat e vet. Para se të ndaheshin tona i tha: "O bir ti je duke shkuar në Itali, mbaje lart krenarinë". Ndërsa Shahini ia kthen: "Nënë mos ki dert se unë do jem dinjitoz". Me këto fjale është ndarë me nënën e tij.

Në '39-n Shqipëria u pushtua nga Italia. Cili ishte qëndrimi i tij ndaj këtij akti?


Pushtimi e zuri në Itali. Në këtë kohë ai ishte në fund të studimit pas akademike. Qeveria fashiste që e pushtoi Shqipërinë, në prill të vitin '39, i dërgoi një mesazh, ku i kerkonte ndihmë që të ndërhynte pranë njerëzve të tij, me qëllim uljen e nivelit antifashist, në zonën e Burrelit meqenëse ishte familje me influencë. Xhaxhai im, Shahin Toçi, i thotë se nuk ndërhynte për këtë gjë. Të kemi parasysh se ai ishte emblema e studentëve shqiptarë në Itali, një intelektual i vërtetë dhe refuzoi të bashkëpunonte me pushtuesit.

Ku qëndron përplasja e tij me fashion?

Në muajin maj, studentët shqiptarë morën pjesë në ceremoninë në prani të Gardës Mbretërore Italiane. Ministria e Luftës donte që me anë të propagandës të njoftohej opinioni nderkombëtar që inteligjencia dhe intelektualët shqiptarë, ushtarake dhe jo ushtarake që studiojnë nëpër vendet e Europës, dhe që i grumbulloi në Romë, ta pranenin pushtimin si "integrimin dhe përparimin e një shoqërie të varfër e të prapambetur". Në këtë rast studentët shqiptar, ndër to Shahin Toçi, xhaxhai ynë, nuk bëri kompromis me strukturën fashiste për këtë lloj ideje. Në këtë rast komanda e akademisë italiane organizoi një ceremoni betimi në shenjë besnikërie me mision e saj në Shqipëri. Ishin mbi 300 studentë shqiptarë që studiojnë në qytete të ndryshme të Italisë dhe që do të bënin një betim solemn në prani të drejtuesve të lartë të ministrisë së Luftës italiane dhe hidheshin me mision në Shqipëri.



Osman Toçi



Kjo Shqipëri ka lindur

A u betuan studentët shqiptarë e bashkë me ta dhe Shahin Toçi?

Italianët mendonin se ata do të ishin një bazë e mirë për të amortizuar rezistencën antifashiste në vendin tonë. Në këtë kohë, xhaxhai ynë Shahin Toçi ishte komandant kuadrati. Tashmë ai njihet si akademist, që e kishte shfaqur hapur qëllimin e tij antifashist dhe rezistencën në këtë lloj misioni. Në ceremoninë e parë të 13 majit, xhaxhai ynë refuzoi me përcimim këtë lloj organizimi. Në prani të një strukture tepër të organizuar fashiste, madje dhe me prani të medias, gjithëka u prish. Përpara se të bënin ceremoninë e dytë italianët për-

dorën të gjithë format për t'ia arritur qëllimit duke krijuar situata të pamundshme për akademikist apo student e tjerë, e duke i joshur se nise do të pranenin betimin do të mbulohehin me gradë të lartë pa testim. Por as kjo nuk u arrit. Pas 7-8 ditësh u organizuar ceremonia e dytë e betimit. Në atë kohë xhaxhai, Shahin Toçi, merr qëndrim më radikal duke u veshur me uniformën shqiptare kuq e zi, dhe i drejtohet komandantit të ceremonisë duke i thënë: "Ne jemi shqiptar dhe kemi ardhur në Itali jo për t'iu nënshtruar fashizmit. Ne jemi shqiptar dhe betohemi vetëm para flamurit kuq e zi. Vetëm atë

KËRKESAT / Si u gjet varri i humbur në varrezat muslimane të Romës

Ështri dëshur një kohë e gjatë që eshtrat e Shahin Toçit të mbërrinin në varrezat e dëshmorëve të Matit. 72 vjet nga dita e vdekjes dhe 18 vjet nga dita që varri i tij, i humbur, u gjet në një nga varrezat e Romës. Rreth këtyre, vështrime Osman Toçi rrëfen: "Ne si familje edhe gjatë kohës së diktaturës kemi bërë kërkesë dhe letra drejtuar Presidencit të Kusvetit Popullor. Por nuk u bë e mundur gjatë 45 viteve. Me ndryshimin e sistemeve dhe ardhjen së demokracisë, ne si nipi si gjëja më e rëndësishme në jetë që duhet të bënim, ishte plotësimi i amanetit të të parëve tanë për t'i gjetur dhe për t'i kthyer eshtrat në atidhe. Vëllai im Shahini, që mbian dhe entri u xhaxhai, është mirë në '93 në Itali me misionin e vetin për të gjetur eshtrat e Shahin Toçit në Romë. Sa Eshtra shumë materiale, dokumente dhe dokumentet të bashkëmbësive të vet dhe



Një ceremoni e rivartimit të Shahin Toçit

njerëzve që kishin jetuar në xhaxhai. Për vështrime ishin të pamundshme. Vëllai bëri tre muaj kërkime, me përkrahjen e ambasadës sonë në Romë. Në 3 korrik 1993 nga administrata u njoftohet ambasada jonë se personi që kerkoni ndodhet në Verano

të Romës në varrezat muslimane. Por me shumë se një vit plotësohet dasja e plotë për rikthimin e këtij patrioti në atidhe. Por shteti shqiptar i asokohe na e rrolloi nëpër zyrë të ndryshme. Vështrime kanë qenë të mëdha sepse asnjë institucion i shtetit

shqiptar nuk u interesua dhe nuk tregoi përpjesë rikthimin e eshtrave të këtij patrioti në atidhe. Dën në vitin 2000 shpallim shqiptarë nuk ka bërë asnjë lëvizje. Çdo gjë ishte bërë nga ana e familjes. Unë mund të shpall se, Shahin Islam Toçi, vëllai im është personi i cili është marrë nga '93 deri në 2001 me këtë eshtrë. Ai ka bërë të mundur gjithëka. Por ai ka treguar se shteti mund të jetë i varfër, por ai ishte i të gatshëm. Edhe në përpleqet e dy viteve të fundit është gjetur shtetë vëllai im që përpari të gjithë materialet dhe dokumentet e nevojshme për rikthimin e eshtrave në atidhe të këtij patrioti. Këtu kemi pasur dhe përkrahjen e ambasadës tonë në Romë, veçanërisht të ambasadorit Luan Koles. Ai na ka ndihmuar konkretisht me rregull institucionale. Ka qenë e mundur zhvartimi i eshtrave nga varrezat e Veranës. Por në gjithë shprehjet janë marrë pasqyrat nga tash.

ISENË" E SJELLJES SË ESHTRAVE TË XHAXHAIT TË TIJ NGA ROMA NË BURREL

se refuzoi të betohej para Duçes



Shahin Toçi

hurra, që nuk njohin dy Flamura

...om, ai është kombi ynë, është ngjyra e flamurit tonë. Kemi ardhur për studime. Ky është qelimi ynë". Në këtë kohë Italianët ndeshen me një rezistencë të madhe e cila i sollë në vëmendje ministrit të Luftës se do të kishin probleme të mëdha në Shqipëri. Nga ky çast studentët shqiptarë i shpërndajnë e interpretojnë në gjithë Italinë. Shahin Toçi me kolegën e dhomës i dërgojnë në një provincë të Romës. Me pas propaganda fashiste shpërndau lajmin se ata kishin

vdekur. Kjo, e pa motivuar. **Në fakt si kishte ndodhur, çfarë u zbulua më pas?** Me forma të ndryshme u arrit të evidentohet se si ishte bërë vrasja e Shahin Toçit në dhomën e tij. Ndër to, një shërbyese e dhomës së hotelit ku banonte xhaxhai tha se ai kishte disa plumba në kokë. U pa qartë se kjo ishte një vrasje e pastër politike. Shahin Toçi, i ishte refuzuar organizimi i varrimit. Duhej të bëhej një ceremoni varrimi, ku të merren pjesë dhe bashkëkombësit e tij, por asnjë nga ata

nuk u lejua. Të kemi parasysh se bashkëkohës të xhaxhait tim ishin Asim Zeneli, Reshit Çollaku, Qazim Kapisyzi, Hamit Keçi e dhjetëra të tjerë. Ata më pas u kthyen dhe e luftuan fashizmin gjatë Luftës Nacional Çlirimtare. Ishin heronjtë e kohës që luftuan fashizmin dhe e shpëtuan Shqipërinë nga pushtuesit.

Cilët kanë qenë ekzekutuesit e Shahin Toçit?

Gjithçka u organizua nga sigurimi i fshetë të shtetit Italian, SIM-i. Në këtë kohë internohen të gjithë studentët shqiptarë të akademive ushtarake në Itali, dhe gjithçka mbeti enigmë. Shtypi dhe propaganda e kohës shkruajtën për këtë plagë të shëmtuar të fashizmit duke e cilësuar si vrasje politike. Një bashkëkohës i xhaxhait tim, Mark Arapi, dërgohet në Sicili si komandant batalioni për strukturat ushtarake paramilitare fashiste. Më pas në dëshminë e tij deklaroi se, dy javë pas vrasjes së Shahin Toçit i vjen një përfaqësues i ministrisë së luftës dhe duke e kontrolluar si një oficer që komandonte trupat italiane. Dhe i thonë: Zoti Arapi përse nuk u betove në ceremoni? Por Mark Arapi i thotë: Zoti kolonel, përgjigjen ta ka dhënë kolegu im Shahin Toçi".

Shahin Toçi është njohur dhe si dëshmor nga të gjitha regjimet?

Në vitin '61 i është dhënë "Urdhri i Trimërisë" nga Presidenti i Kuvendit Popullor, nënshkruar nga Haxhi Lleshi. Në vitet '70 është shpallur dëshmor. Në '94 nga ish-presidenti Berisha i është dhënë Urdhri i Klazit të Parë me motivacion: "Atdhetar i shquar". Në po këtë vit i është dhënë certifikata e dëshmorit. Në 2011-n është dekoruar nga Presidenti i Republikës Bamir Topi me "Urdhër dhe artë të shqiponjës".

CEREMONIA

"Odiseja" e gjatë për të mbërritur në vendlindje

Tanimë eshtrat e Shahin Toçit prehen në vendlindje. Osman Toçi, një nga nipat e tij, thotë se pas shumë vitesh mundimi ndihet më i qetë që amanetin arriti ta mbante: "Në 1993, vëllai im me emrin Shahin, më njoftoi me telefon nga Roma: "Do të shkosh te baba e tek xhaxhai e t'u thuash se kam gjetur varrin e Shahin Toçit". Shkoj në shtëpi dhe ua komunikoj lajmin. Shumë i papritur, as nuk e mendonin. Shfaqën një gëzim të jashtëzakonshme, e prisnin prej 45 vitesh këtë lajm. Në jetën time aty kam parë babanë me një gëzim të madh. Varri i xhaxhait i gjet në 3-korrik-93 kurse baba më ka vdekur në 17 korrik 1993, pra vetëm pak ditë më pas. Ishte një emocion dhe diçka e brendshme nga ana e babait që e përjetonim ditë pas dite. Ai u thoshte njerëzve: "Nuk ka gëzim më të madh për mua si prind dhe vëlla, për atë që më ka bërë djali". Meritë të madhe në këtë akt kishin dhe prindërit e mi, baba Islami, nëna ime Dushe e xhaxha Avdyli. Por babai, Islami, ndërroi jetë për pak ditë. Ka qenë një dramë e vërtetë në familje. Edhe gëzim dhe dhimbje. Por Shahin Toçi, është krenaria e familjes edhe sot që ne transmetojmë këtë lloj mesazhi edhe për shoqërinë, për vlerat kombëtare të tilla që duhen trashëguar ndër breza e vite. Ditën shumë e gëzueshme ishte kur sollëm eshtrat në atdhe. Ne si nipa kishim një amanet, që mbeti i jashtëzakonshëm. Ishte emocion i papërshkrueshëm që më në fund eshtrat e xhaxhait tonë do të preheshin në atdhe. Te të parët e vet, te toka e vet, për të cilin fali jetën në lule të rinisë. Si një shqiptar e patriot i madh i kombit ai nuk mund të rrinte në tokë të huaj. Ne bëme çmos si familje, si nipa, duke e respektuar dhe shtetin tonë, që e vlerësoi këtë figura, ndaj dhe në ceremoninë rivarrosjes së eshtrave të Shahin Toçit, në varrezat e dëshmorëve të Marit, respektuam në mënyrë të veçantë Ministrinë e Mbrojtjes, Arben Imami, shefin e Shtabit të Përgjithshëm Maks Malaj, që u gjendën dhe na dhanë mundësinë për t'i bërë një ceremoni dinjitoze ushtarake ashtu siç i kishte hije një patrioti.



Nga ceremonia e rivarrimit të Shahin Toçit

...OMITË / FAMILJA TOÇI, SI E PËRÇMOI PENSIONIN E FASHISTËVE

"Odiseja" e gjatë për të mbërritur në vendlindje

Tanimë eshtrat e Shahin Toçit prehen në vendlindje. Osman Toçi, një nga nipat e tij, thotë se pas shumë vitesh mundimi ndihet më i qetë që amanetin arriti ta mbante: "Në 1993, vëllai im me emrin Shahin, më njofton me telefon nga Roma: "Do të shkosh te baba e tek xhaxhai e t'u thuash se kam gjetur varrin e Shahin Toçit". Shkoj në shtëpi dhe ua komunikoj lajmin. Shumë i papritur, as nuk e mendonin. Shfaqën një gëzim të jash-tëzakonshme, e prisnin prej 45 vitesh këtë lajm. Në jetën time aty kam parë babanë me një gëzim të madh. Varri i xhaxhait i gjet në 3-korrik-93 kurse baba më ka vdekur në 17 korrik 1993, pra vetëm pak ditë më pas. Ishte një emocion dhe diçka e brendshme nga ana e babait që e përjetonim ditë pas dite. Ai u thoshte njerëzve: "Nuk ka gëzim më të madh për mua si prind dhe vëlla, për atë që më ka bërë djali". Meritë të madhe në këtë akt kishin dhe prindërit e mi, baba Islami, nëna ime Dushe e xhaxha Avdyli. Por babai, Islami, ndërroi jetë për pak ditë. Ka qenë një dramë e vërtetë në familje. Edhe gëzim dhe dhimbje. Por Shahin Toçi, është krenaria e familjes edhe sot që ne transmetojmë këtë lloj mesazhi edhe për shoqërinë, për vlerat kombëtare të tilla që duhen trashëguar ndër breza e vite. Ditën shumë e gëzueshme ishte kur sollëm eshtrat në atdhe. Ne si nipa kishim një amanet, që mbeti i jash-tëzakonshëm. Ishte emocion i papërshkrueshëm që më në fund eshtrat e xhaxhait tonë do të preheshin në atdhe. Te të parët e



Nga ceremonia
e rivarrimit
të Shahin Toçit

KERKESAT / Si u gjet varri i humbur në varrezat muslimane të Romës

Është dashur një kohë e gjatë që eshtrat e Shahin Toçit të mbërrijnë në varrezat e dëshmorëve të Matit. 72 vjet nga dita e vdekjes dhe 18 vjet nga dita që varri i tij, i humbur, u gjet në një nga varrezat e Romës. Rreth këtyre, vështirësinë Osman Toçi rrëfen: "Ne si familje edhe gjatë kohës së diktaturës kemi bërë kërkesë dhe letra drejtuar Presidiumit të Kuvendit Popullor. Por nuk u bë e mundur gjatë 45 viteve. Me ndryshimin e sistemeve dhe ardhjes së demokracisë, ne si nipa si gjëja më e rëndësishme në jetë që duhet të bënim, ishte plotësimi i amanetit të të parëve tanë: për t'i gjet dhe për t'i kthyer eshtrat në atdhe. Vëllai im Shahini, që mban dhe emrin e xhaxhait, është nisur në '93 në Itali me misionin e vetëm për të gjetur eshtrat e Shahin Toçit në Romë. Ne kishim shumë materiale, dorëshkrime dhe dokumentet të bashkëkohësve të vet dhe



Nga ceremonia e rivarrimit të Shahin Toçit

njerëzve që kishin jetuar me xhaxhain. Por vështirësitë ishin të paimagjueshme. Vëllai bëri tre muaj kërkime, me përkrahjen e ambasadës sonë në Romë. Në 3 korrik 1993 nga administrata njoftohet ambasada jonë se personi që kërkoni ndodhet në Verano

të Romës në varrezat myslimane. Për më shumë se një vit plotësohet dosja e plotë për rikthimin e këtij patrioti në atdhe. Por shteti shqiptar i asokohe na sorollati nëpër zyra të ndryshme. Vështirësitë kanë qenë të mëdha sepse asnjë institucion i shtetit

shqiptar nuk u interesua dhe nuk mori përsipër rikthimin e eshtrave të këtij patrioti në atdhe. Deri në vitin 2010 shteti shqiptar nuk ka bërë asnjë lëvizje. Çdo gjë është bërë nga ana e familjes. Unë mund të shtoj se, Shahin Islam Toçi, vëllai im është personi i cili është marrë nga '93 deri në 2011 me këtë çështje. Ai ka bërë të mundur gjithçka. Por ai ka treguar se shteti mund të jetë i varfër, por ai është i të gjithëve. Edhe në përpjekjet e dy viteve të fundit është pikërisht vëllai im që përgatiti të gjithë materialet dhe dokumentet e nevojshme për kthimin e eshtrave në atdhe të këtij patrioti. Këtu kemi pasur dhe përkrahjen e ambasadës tonë në Romë, veçanërisht të ambasadorit Llesh Kolës. Ai na ka ndihmuar konkretisht në rrugë institucionale, ku u bë e mundur zhvarrimi i eshtrave nga varrezat e Veranës. Por të gjitha shpenzimet janë marrë përsipër nga familja".

DITËT E MORTIT / FAMILJA TOÇI, SI E PËRÇMOI PENSIONIN E FASHISTËVE

Pra ka qenë e vështirë sjellja e eshtrave të këtij patrioti në vendlindje? Nipi i tij Osman Toçi thotë: "Jashtë mase e vështirë. Në kohën e vrasjes së xhaxhait, nga gjyshërit e mi është mbajtur 40 ditë morti i hapur në fshatin Uzallë të Matit. 45 ditë pas vrasjes komanda fashiste dhe Ministria e Luftës njoftoi gjyshin tim që të shkonte në portin e Durrësit për të tërhequr shtatë valixhe me libra dhe

veshje që ishin pronë e Shahinit. Gjyshi shkon bashkë me dy kushërinjtë e vet. Ai u bëri një pyetje dy oficerëve italianë që i sollën rrobat e Shahinit: "Si ma vratë djalin?" Një nga oficerët, me origjinë kalabreze, i thotë: "Nuk ta shpjegojmë dot më gjatë, vetëm se t'i duhet të jesh krenar për djalin tënd". E mbyllën bisedën duke i thënë se kishte të drejtë që të bënte një kërkesë për pension. Por gjyshi e refuzon me përçmim duke

i thënë se nuk e pranonte pensionin e fashizmit dhe nuk shkelte mbi gjalun e djalit të tij. Me valixhet e Shahinit kthehen në fshatin e lindjes, ku fillon morti dhe një emocion i paimagjueshëm. Këtë e kam të treguar kushedi sa herë nga prindërit. Shtëpia që nga ato kohë e deri më sot qëndron si shtëpi muze. Për jetën akademike të Shahin Toçit dëshmojnë materialet që ekzistojnë sot e kësaj dite.